



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARE

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-22355. Fax: 0393-22533. E-mail: bashkiahimare@yahoo.com

Nr. 1161/ Prot.

Himare me, 15/04/2016

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL PËR KATEGORINË EKZEKUTIVE (SPECIALIST)

Në zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V të Vendimit nr.243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", Bashkia Himare shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet si me poshte vijon :

- 1(nje) Specialist Kontabilist i shpenzimeve dhe te ardhurave , në Njesine Administrative Lukove, Bashkia Himare.

* Pozicionet e lartpërmendur iu ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

* Vetëm në rast se për këtë pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezulton se vendi është përsëri vakant, pozicioni është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dyja procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë.

Data e dorëzimit të dokumentave:

Lëvizje paralele : 25.04.2016

Data e dorëzimit të dokumentave: 30.04.2016

Pranim ne shërbimin Civil

Përshkrim përgjithsues i punës dhe Kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët:

- **1 (nje) Specialist Kontabilist i shpenzimeve dhe te ardhurave , në Njesine Administrative Lukove, Bashkia Himare.**

Të zotëroje Diplome Universitare të nivelit Bachelor/ Master Profesional / Master Shkencor sipas legjislacionit të arsimit të lartë ne Finance /Kontabilitet.

Te njohin dhe te perdorin shume mire programin Microsoft office dhe Alpha Platinum . Vjetersia ne pune perben avantazh.

Përshkrimi i punes

- a. . Bën transferimet si për fondet buxhetore dhe për të ardhurat, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në dokumentacionin e nevojshëm për dhënien e fondeve për investimet e prokuruarra, me urdher te Kryetarit te Bashkise.
- b. . Bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit të vitit ushtrimor, ndjek në vazhdimësi përdorimin e fondeve si buxhetore ashtu dhe nga të ardhurat për të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet vartëse, bën rakordime me Degën eThesarit, harton pasqyrat përkatëse dhe raporton ne organet sipas ligjit.
- c. . Bën rakordime me degën e Buxhetit dhe Degën e Thesarit për çeljen e fondeve dhe realizimin faktik të tyre.

ç. Bën ndjekjen e veprimeve me thesarin (likuidimin e urdhër pagesave të përpiluara nga Pergjegjesi i Sektorit te Finances dhe Buxhetit etj.

b) Merr pjesë aktive, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit duke kontrolluar ligjshmërinë e vendimeve të komisionit duke propozuar marrjen e masave në mbështetje të ligjit.

c) Mban përgjegjësi për përzgjedhjen e procedurës, vendosjen e afateve dhe respektimin e tyre duke iu referuar në çdo hap legjislacionit në fuqi

ç) Ka për detyrë të informojë në çdo kohë mbi legjislacionin dhe ndryshimet që i bëhen këtij të fundit dhe të pasqyrojë në dokumentat e tenderit dhe procedurat e tenderimit këto ndryshime. Etj.

I - LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë :

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv, mirë apo shumë mirë nga punëdhënësi i fundit

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë të paktën një diplomë Universitare të nivelit Bachelor/Master Profesional /Master Shkencor sipas specifikimit të pozicionit.
- Pervoja në punë ,Njohja e gjuhës së huaj Anglisht ose ndonjë gjuhë tjetër përbën avantazh.
- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë aftësi të mira komunikimi
- Njohje të programeve bazë kompjuterike Microsoft Office dhe Alpha Plantinum.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose dorazi pranë Njesisë të Burimeve Njerëzore dhe Informacionit të Bashkisë Himare dokumentat si më poshtë:

1. Kerkese me shkrim për aplikim (leter motivimi)
2. Curriculum Vitae (Jetshkrim standart)
3. Fotokopjo të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
4. Certifikate të perberjës familjare dhe fotokopje kartës së Identitetit.
5. Dëshmi kualifikimi (fotokopjo e notëruar) nëse ka.
6. Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.
7. Vertetim që nuk kanë masë administrative në fuqi
8. Dëshmi i gjendjes gjyqësore.
9. Raport mjeko –ligjor nga komisioni mjekësor kompetent i aftë për punë
10. Fotokopjo të Librezës së punës.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **27.04.2016** Njesia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit të Bashkisë Himare do të shpallë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë .

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njesia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit të Bashkisë Himare , nëpërmjet email- it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithsues të punës për pozicionin.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë e tyre mbi :

- Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, kapitulli VI për Qeverisjen Vendore

- Ligjin nr. 139 Date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore"
- Ligji nr 9367 date 07.04.2005 "Per parandalimin e konfliktit te interesave".
- Ligjin Nr.9131 date 08.09.2003 "Per rregullat e etikës në administratën publike".
- Ligji nr 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga diskriminimi".
- Ligji nr 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".
- Njohuritë mbi ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 "Për transferimin e Pronave të paluajteshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 119/2014 "Per te drejten e Informimit".
- Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr. 120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale".
- Ligji nr. 10296 date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen me pikë sipas skemës së vlerësimit si më poshtë:

- **40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar** (20 pikë - përvoja; 10 pikë – trajnimet ose kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse ; 10 pikë - vlerësimet e rezultateve individuale në punë).
- **60 pikë intervista me gojë.**

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm .

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himare do të shpallë fituesin në portalin Sherbimi Kombëtar I Punësimit, Faqjen Zyrtare te Bashkise , dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike .

II - PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se për këto pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezulton se vendi është përsëri vakant, pozicioni është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

1-Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë të paktën një diplomë Universitare të nivelit Bachelor/Master Profesional /Master Shkencor sipas specifikimit të pozicionit.
- **Pervoja ne pune ,Njohja e gjuhes se huaj Anglisht ose ndonjë gjuhë tjetër përbën avantazh.**
- Mbjatesi i ketij pozicioni duhet te ketë aftesi te mira komunikimi
- Njohje të programeve bazë kompjuterike Microsoft Office dhe Alpha Platinum.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose dorazi pranë Njesise te Burimeve Njerëzore dhe Informacionit të Bashkisë Himare , Brenda dates 30.04.2016 dokumentat si më poshtë:

- 1.Kerkese me shkrim per aplikim (leter motivimi)
- 2.Curriculum Vitae (Jetshkrim standart)
- 3.Fotokopjo të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
- 4.Certifikate të perberjës familjare dhe fotokopje kartës së Identitetit.
- 5.Dëshmi kualifikimi (fotokopjo e notëruar) nese ka.
- 6.Vleresim pune nga punëdhenësi i fundit.
- 7.Vertetim që nuk kanë masë administrative në fuqi
- 8.Dëshmi i gjendjes gjyqësore.
- 9.Raport mjeko –ligjor nga komisioni mjekesor kompetent i aftë për punë
- 10Fotokopjo të Librezës së punës te te gjitha rubrikave te plotesuara.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **10.05.2016** Njesia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit te Bashkisë Himare do të shpallë në Sherbimin Kombëtar te Punesimit, Faqjen Zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta dhe kushtet e pranimit në shërbimin civil , si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për pranimin në shërbimin civil do të njoftohen individualisht nga Njesia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit te Bashkisë Himare , nëpërmjet email- it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë e tyre mbi :

- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Kushtetuta e Republikës se Shqipërisë, kapitulli VI per Qeverisjen Vendore
- Ligjin nr. 139 Date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”
- Ligji nr 9367 date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te intereresave”.
- Ligjin Nr.9131 date 08.09.2003“Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligji nr 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Ligji nr 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqeri” .
- Njohuritë mbi ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për transferimin e Pronave të paluajtëshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 119/2014 ‘‘Per te drejten e Informimit’’.

- Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr. 120/2014 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale".
- Ligji nr. 10296 date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithsues të punës për pozicionin.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen me pikë sipas skemës së vlerësimit si më poshtë:

- **15 pikë për dokumentacionin e dorëzuar**
- **25 pikë intervista me gojë.**
- **60 vlerësimi me shkrim.**

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm .

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himare do të shpallë fituesin në portalin Sherbimi Kombetar i Punesimit , Faqen Zyrtare të Bashkisë , dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike .

BASHKIA HIMARE

Njesia e Burimeve Njerezore dhe Informacionit